



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT



Бр./Nr _____

_____ р./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 nga Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë " Nr. 12/2019) neni 40 paragrafi 3 nga Rregullorja për punë të Komisionit Shtetërorë për Parandalimin e Korrupsionit, duke vepruar sipas denoncimit të parashtruar nga parashtrues i panjohur KSHPK (në tekstin e mëtejshëm) në vazhdimin e seancës së 54-të, të mbajtur më 02.11.2021, morri vendimin vijues:

VENDIM

Procedura sipas lëndës me nr. 09-4412 / 1 datë 29.12.2020, i formuar pas denoncimit të dorëzuar për personin zyrtar ///, anëtare e Bordit Drejtues në ///, NDËRPRITET.

Pas verifikimit dhe analizimit të të dhënave, KSHPK-ja konstatoi se ka ndryshim të gjendjes faktike, personi zyrtar /// është shkarkuar nga pozita e anëtarit të Bordit Drejtues /// /// ///. Vendimi në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimmarrjes.

Arsyetim

Më datë 29.12.2020 është dorëzuar denoncim me pretendimin se kryetari i Komunës /// ka të punësuar bashkëshorten e tij /// në ///. Në të njëjtën kohë, personi i përmendur ka kumulim të funksioneve sepse është anëtar i Bordit Drejtues ///, si dhe është gjyqtar porotë.

Për arsye të verifikimit të pretendimeve të bëra në denoncim, KSHPK ka bërë inspektim në bazën e të dhënave për regjistrimin e listave anketuese dhe deklaratave të interesit dhe ka konstatuar se me datë 30.07.2021, personi në fjalë ka dorëzuar listë anketuese për përfundimin e detyrës.

Po ashtu, personi /// është i punësuar si zyrtar administrativ në /// në pajtim me Ligjin nëpunës administrativ, ku sipas ligjit kryetari i Komunës /// nuk ka kompetenca dhe nuk mund të përfshihet në procedurë d.m.th. në rastin konkret nuk mund të konstatohet shkelje e nenit 74 të ///.

Duke pasur parasysh të theksuarën e mësipërme, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit vendosi si në dispozitën e këtij vendimi.

Përgatiti: S.M

Miratoi: KN, anëtar i KSHPK-së

**KOMISIONI SHTETËRORË PËR
PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT**

**KRYETAR,
Biljana Ivanovska**